



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 të Rregullores (ZKA) Nr.01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit me datën 3 prill 2020, shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli:	Këshilltar i Lartë për Medie
Nr. i referencës:	KLM/ZKA/08-04/20
Koeficienti:	ZKA/05
Lloji i Pozitës:	Nivel profesional në fushën e auditimit
Orët e Punës:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pa caktuar
Vendi i punës:	Rr. Ahmet Krasniqi 210 (selia e Zyrës Kombëtare të Auditimit)
Qëllimi i vendit të punës:	Kryerja e detyrave profesionale për promovimin e auditimit kundrejt palëve të jashtme me fokus mediat dhe organizatat profesionale.
I përgjigjet:	Drejtorit të Departamentit Për Komunikim dhe Zhvillim Profesional

Detyrat dhe përgjegjësitë themelore:

1. Ofron përkrahje profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit;
2. Ofron përkrahje profesionale në përgatitjen e propozimeve dhe hartimin e strategjisë dhe planeve të komunikimit me media;
3. Duke mbajtur kontakte të rregullta me media dhe duke përgatitur e zbatuar projekte konkrete për bashkëpunim me mediat ndihmon në rritjen e transparencës dhe informimin e publikut për rezultatet e auditimit;
4. Përgatitë materialet e nevojshme për konferenca për media, njoftimet, lajmet e komunikatat dhe përgatitë raporte për media dhe rrjetet sociale;
5. Propozon dhe përgatitë për botime si buletine, broshura, libra etj. me qëllim zhvillimin e auditimit të jashtëm dhe ofrimin e rezultateve audituese;
6. Redakton produktet kryesore të ZKA-së, veçmas RVA, RVP dhe librat e botura;
7. Këshillon departamentet e auditimit për përmbledhjen e përgjithshme të raporteve të auditimit;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet e kërkuara dhe përvoja për këtë vend pune:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale; dhe
- Njohja e së paku njëres gjuhë zyrtare në Kosovë dhe njohja e gjuhës angleze.

Shkathtësitë e kërkuara për këtë vend pune:

- Të punuarit me njerëz;
- Prezantimi dhe komunikimi i informacionit;
- Planifikimi dhe organizimi;
- Shpërndarja e rezultateve dhe përmbushja e pritjeve;
- Përballja me presione dhe pengesa;
- Arritja e qëllimeve dhe objektivave personale të punës;
- Shkrimi dhe raportimi;
- Analizimi;
- Ndërlidhja dhe rrjetizimi;
- Adoptimi dhe reagimi ndaj ndryshimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi.

Vetëm formulari zyrtar i aplikimit do të merret parasysht. Formularët (aplikacionet) e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen, gjithashtu kandidatët e të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës së punësimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat e shkruara dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 03.04.2020, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 18.04.2020, ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën <http://www.zka-rks.org> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.